

1 E mërkurë, 17 prill 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratë përmyllëse]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.31

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi. Mirë se vini.

8 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
11 Specializuar kundër z. Pjetër Shalës. Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Z. Prokuror, dua të di kush është i pranishëm sot në
15 Gjykatë. Shoh që ka një ndryshim në përbërjen e ekipit tuaj.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të gjithëve. Sot
17 kemi Max Karakul, që është stazhiere. Pjesa tjetër e ekipit
18 është e njëjtë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Mbrojtës i Viktimave, shoh që përbërja e ekipit tuaj
22 është e njëjtë si dje. Shumë mirë. Në rregull.

23 Avokat i Mbrojtjes.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Faleminderit. Jemi këtu me z.
25 Shala, kësaj radhe është këtu me ne në sallën e gjyqit. Ekipi

1 jonë ka të njëjtën përbërje me përjashtim të Annie Laguex, që
2 është këshilltare ligjore e pranishme këtu sot me ne.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Z. Shala, mirë se vini.

6 Të hënën dhe të martën dëgjuam fjalën përfundimtare të
7 Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Mbrojtjes së Viktimave
8 dhe pjesërisht fjalën përfundimtare të Mbrojtjes. Ka ngelur
9 një pjesë.

10 Me sa kuptoj, ju drejtohem juve Avokat, ju duhet seanca e
11 paradites së sotme për të përfunduar fjalën tuaj. Në qoftë se
12 ka ndonjë ndryshim sa i përket kohës që ju duhet na informoni,
13 ju lutem. Përndryshe ju jap fjalën që tani që të vazhdoni më
14 tej.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë. Koha që na
16 nevojitet është ajo që kemi thënë dje dhe me lejen tuaj po ia
17 kaloj fjalën znj. Cariolou.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
19 keni fjalën.

20 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve.

21 Sot do vazhdojmë aty ku ngelëm dje, me pikën 4 të akuzës,
22 ku z. Shala akuzohet për vrasje si pjesëtar i NKP-së me
23 synimin për të vrarë apo si pjesëmarrës në NKP duke ditur që
24 kjo do të çonte në vrasje apo me vetëdije duke pranuar këtë
25 rrezik si ndihmës apo nxitës. Dua të trajtoj tre pika përpara

1 që të trajtoj akuzat e Prokurorisë bazuar në doktrinën e NKP-
2 së dhe provat e paraqitura lidhur me këtë.

3 Së pari, Prokuroria pretendon [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 Nuk është paraqitur asnjë provë se i akuzuari ishte i
10 fshirë apo i lidhur me ndonjë, kishte të bënte me këtë
11 incident.

12 Së dyti, Prokuroria, qëndrimi i Prokurorisë është që më 4
13 qershor 1999, pjesëtarë të UÇK-së, persona të tjerë dhe jo z.
14 Shala, qëlluan me armë dhe plagosën dy personat e identifikuar
15 në aktakuzë dhe se i akuzuari ishte i pranishëm dhe mori pjesë
16 në rrahje.

17 Ashtu siç e përmendi z. Aouini, Dëshmitari 1 është në
18 fakt i vetmi dëshmitar që pretendoi se z. Shala ishte i
19 pranishëm gjatë këtij incidenti. Trupi Gjykses duhet të
20 trajtojë këtë provë, këtë dëshmi me kujdes të shtuar. Nuk
21 është vlerësim që është kompetencë vetëm e Trupit Gjykses kjo
22 duke patur parasysh tendencën e tij për të gënjyer, të
23 kaluarën e tij dhe lidhjen me z. Shala, kjo është një kërkim,
24 kusht absolut. Dëshmia e Dëshmitarit 1 nuk mund të pranohet pa
25 mbështetje për asnjërën nga -- për ndonjërën nga akuzat e

1 ngritura.

2 Së treti, qëndrimi i Prokurorisë është që njëri prej
3 faktorëve që ka çuar në vdekjen e të ndaluarit ishte trajtimi
4 mjekësor i pamjaftueshëm që i është dhënë atij pasi viktima
5 është qëlluar me armë. Provat e paraqitura nga Prokuroria, siç
6 e kemi diskutuar në paragrafin 166, 1669 të dosjes sonë
7 përfundimtare, viktimës i është dhënë ndihmë mjekësore pasi
8 është qëlluar me armë.

9 Tani, Mbrojtja nuk ka ndonjë qëndrim lidhur me
10 përshtatshmërinë e trajtimit mjekësor të dhënë. Ajo që duhet
11 të theksohet është se i akuzuari nuk kishte as në pozitë që të
12 jepte, të autorizonte, të udhëzonte apo të lejonte dhënien e
13 ndihmës mjekësore asnjë personi të pranishëm në fabrikën e
14 metalit në Kukës. Në rrethana të tilla, ai nuk mund të mbahet
15 përgjegjës për vdekjen e një personi i pranishëm aty për shkak
16 të apo si rezultat i dhënies së ndihmës mjekësore të
17 pamjaftueshme apo të papërshtatshme.

18 Sidoqoftë, Dëshmitari 1 nuk ngriti ndonjë akuzë që
19 përfshinte të akuzuarin në vendimin e pretenduar për t'i
20 mohuar ndihmë viktimës ndihmën mjekësore.

21 Tani, Prokuroria akuzon z. Shala me vrasje duke u
22 mbështetur në dy format e përgjegjësisë sipas ndërmarrjes
23 kriminale të përbashkët, e para dhe e treta. Siç e dimë,
24 parimi i ligjshmërisë zbatohet jo vetëm për veprat penale por
25 edhe për format e përgjegjësisë. Ftoj Panelin si shembull që

1 të konsultoj në jurisprudencë vendimin e dhomës së apelit në
2 çështjen Milutinovic dhe të tjerë, datës 22 mars 2006.

3 Kodi Penal i 1997 që zbatohet në Kosovën e vitit 1999 nuk
4 parashihte përgjegjësinë përmes pjesëmarrjes në një ndërmarrje
5 kriminale të përbashkët. Neni 22 i Kodit Penal parashihte
6 përgjegjësinë për bashkëkryerësit të cilët qartësisht synonin
7 kryerjen e aktit kriminal. Ky është nocioni klasik i
8 bashkëkryerjes. Neni 26 i Kodit Penal i 1997, ka të bëjë me
9 krijimin apo përdorimin e grupimit kriminal me synimin e
10 kryerjes së akteve kriminale por ky nuk përmend fare të
11 ashtuquajturën kriterin e parashikueshmërisë.

12 Jurisprudenca e Gjykatës së Apelit të Kosovës ka
13 konfirmuar në aktgjykimet e tyre në çështjen J.D. dhe të tjerë
14 siç janë Xh. K., se NKP-ja dhe po citoj këtu "nuk kishte një
15 prej formave të përgjegjësisë penale parashikuar në ndonjërin
16 prej kodeve të zbatueshme".

17 Qëndrimi jonë është që ligji penal në Kosovë nuk
18 përfshinte, nuk përmban asnjë formë të NKP-së që përfshin
19 përgjegjësinë, këtë përgjegjësi.

20 Jo vetëm që ndërmarrja kriminale e përbashkët nuk
21 përfshihej në Kodin Penal të RFSJ-së, po ajo shprehimisht
22 përjashtohet nga ligji i Dhomave të Specializuara të Kosovës.
23 Interpretimi i zgjeruar i formulimit të nenit 16(1)(a) të
24 ligjit mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës për të fshirë
25 këtu përgjegjësinë sipas NKP-së do të bëhej, në qoftë se bëhej

1 një gjë do të bëhej në dëm të të akuzuarit dhe do të ishte
2 shkelje e parimit të ligjshmërisë.

3 Për më tepër, siç e parashtruar në paragrafin 267, 271 të
4 dosjes tonë përfundimtare, qëndrimi jonë është që NKP-ja në
5 përgjithësi dhe NKP III në veçanti, nuk janë përcaktuar në
6 ligjin ndërkombëtar zakonor në 1999 dhe nuk mund të krijojnë
7 përgjithësi për veprat e kryera në atë kohë.

8 Siç e kemi thënë në dosjen tonë, në apelin në rastin
9 Tadic, konsiderohet gjerësisht si vendim themelues i
10 përgjegjësisë së ndërmarrjes kriminale të përbashkët në ligjin
11 ndërkombëtar është nxjerrë vetëm më 15 qershor 1999. Afati
12 kohor për NKP-në e pretenduar që kemi në aktakuzë fillon më 17
13 maj dhe përfundon më 5 qershor 1999. Që do të thotë, që vjen
14 pas aktgjykimit të apelit në çështjen Tadic.

15 Ligji penal duhet të jetë i ditur, i kuptueshëm dhe i
16 parashikueshëm në mënyrë që i akuzuari të dijë se cilat akte
17 bëjnë krime. Në këtë rast nuk ka ndodhur kjo gjë. Dhe kjo
18 është e qartë. Z. Shala nuk mund të dinte paraprakisht që ai
19 do të akuzohej për ndonjë krim që nuk synonte ta kryente duke
20 u bazuar thjesht në rregulla të ndërtuar nga organi gjyqësor i
21 ligjit zakonor ndërkombëtar që do të zbatoheshin pastaj në
22 mënyrë retroaktive ose do të konsideroheshin pjesë e ligjit të
23 Kosovës pas 20 vitesh.

24 Numri i vogël i çështjeve pas Luftës së Dytë Botërore të
25 përdorura për të mbështetur këtë nocion ishin të paditura për

1 të, janë parashtruar në një gjuhë që ai nuk e kupton, nuk e
2 lexon dhe sidoqoftë ishin të papërcaktuara qartë sa i takon
3 fushëveprimin të kësaj forme përgjegjësie.

4 Përveç problemit të rëndë që z. Shala akuzohet në bazë të
5 përgjegjësisë së tij të pretenduar në NKP, Prokuroria ka
6 dështuar tërësisht që të vërtetojë se ishin persona, disa
7 persona, pra, në numër të shumtë që kanë vepruar së bashku për
8 të arritur synimin e përbashkët për të vrarë të ndaluarit në
9 fabrikën e metalit në Kukës, siç pretendon ajo dhe një synim i
10 tillë nuk mund të nxirret apo të deduktohet nga provat e
11 paraqitura.

12 Disa dëshmitarë kanë paraqitur prova se rrahja e të --
13 disa dëshmitarë kanë dhënë dëshmi dhe kanë vërtetuar se duke
14 thënë se rrahjet e të ndaluarve kanë pushuar së ndodhuri më 5
15 qershor 1999, ditën kur është identifikuar, kur personi që
16 është personi i identifikuar në aktakuzë ka vdekur. Pas kësaj
17 datës, sipas qëndrimit të Prokurorisë, një person tjetër ka
18 qenë i përgjegjës për këtë, që ka përmirësuar kushtet dhe
19 keqtrajtimet kanë përfunduar.

20 Në të njëjtën mënyrë Dëshmitari 1448 thotë që "rrahjet e
21 zakonisht pushuan, nuk ndodhën më" pas datës 5 qershor.
22 Dëshmitari 1448 po ashtu deklaroi se Xhemshit Krasniqi ka
23 luajtur rol të rëndësishëm në përmirësimin e menjëhershëm të
24 kushteve të ndalimit. Dëshmitari 1448 po ashtu deklaroi se pas
25 vdekjes së viktimës, Xhemshit Krasniqi "ishte i nervozuar dhe

1 përdorte fjalë të ashpra ndaj ushtarëve të UÇK-së. Duke thënë
2 që 'Kjo nuk do të ndodhë më këtu'".

3 Këto prova mbështeten nga Dëshmitari 4 i cili deklaroi se
4 pastaj erdhën roje profesionale, që menjëherë pas vdekjes së
5 të ndaluarit, të cilët përmirësuan kushtet e ndalimit.

6 Këto sugjerojnë që pas vdekjes së të ndaluarit në fjalë,
7 u morën masa nga ata që ishin përgjegjës aty, fshirë edhe z.
8 Krasniqi, për t'u siguruar që të ndaluarit të trajtoheshin në
9 mënyrë njerëzore. Ata ndryshuan, zëvendësuan personat që ishin
10 përgjegjës për të ndaluarit, përmirësuan kushtet e ndalimit të
11 tyre dhe kjo për të siguruar, sipas fjalëve të Krasniqit, që
12 "kjo nuk do të ndodhte më". Të nderuar Gjykatës, si është kjo
13 në koherente apo përputhet me qëllimin apo synimin për të
14 vrarë të ndaluarit?

15 Këto prova kundërshtojnë në mënyrë të drejtpërdrejt
16 pretendimin e Prokurorisë se grupi përgjegjës për të ndaluarit
17 në Kukës - dhe z. Shala nuk ka qenë kurrë asnjëherë pjesëtar i
18 këtij grupi - kishin qëllimin e përbashkët, synimin e
19 përbashkët për t'i vrarë ata. Në fakt, provat vërtetojnë se
20 personat përgjegjës nuk donin që të vrisnin asnjë të ndaluar,
21 atyre u ka ardhur keq për atë që ka ndodhur dhe menjëherë kanë
22 marrë masa për t'u siguruar që kjo nuk do të ndodhte më.

23 Gjithashtu, provat mbi të cilat mbështetet Prokuroria
24 lënë të besohet se pavarësisht trajtimit mjekësor që ishte në
25 dispozicion kjo është dhënë individit, kjo i është dhënë, pra,

1 ofruar kjo ndihmë mjekësore individit që ishte i lënduar. Dhe
2 kjo tregon se grupi nuk donte që t'i vriste ata apo t'i linte
3 të vdisnin.

4 E rëndësishme është se ata që ishin përgjegjës për të
5 ndaluarit dhe ata që pretendohet të kenë keqtrajtuar dy
6 viktimat nuk ishin persona të ndryshëm. Nuk është rasti ku
7 komandantët zbulojnë që vartësit e tyre veprojnë në mënyrë të
8 paligjshme dhe menjëherë marrin masa për t'u siguruar që kjo
9 nuk ndodhë asnjëherë. Personi përgjegjës aty, sipas
10 Dëshmitarit 1, të paktën sipas versionit të fundit të dëshmisë
11 së tij, është personi që, në fakt, qëlloi viktimën.

12 Së fundmi, nuk ka prova, nuk është paraqitur asnjë provë
13 që vërteton që i akuzuari donte të vriste këtë person.
14 Përkundrazi, i akuzuari nuk kishte dijeni dhe nuk luajti asnjë
15 rol në vrasjen e pretenduar. Ai është informuar për vdekjen e
16 tij shumë kohë pas përfundimit të luftës.

17 Nuk janë paraqitur, nuk është paraqitur asnjë provë që
18 tregon që vdekja e këtij individi ishte diçka që i akuzuari
19 mund ta parashikonte.

20 Siç është konstatuar në gjykimin Geci, kjo vdekje nuk ka
21 ndodhur si ajo gjë që ndodhi me keqtrajtimet e të ndaluarve që
22 pretendohet të ketë ndodhur në fabrikën e metalit të Kukësit.

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 Asnjë provë nuk është paraqitur që sugjeron ndryshe. Në
7 fakt, vdekja dhe duket që vdekja e të ndaluarit ka qenë një
8 incident i izoluar.

9 Qëndrimi jonë është që të gjitha këto elemente tregojnë
10 sesa pak gjasa kishte që i akuzuari të mund të parashikonte që
11 ky i ndaluar të qëllohej me armë dhe të lihej të vdiste.

12 Dhe sugjerimi apo pretendimi që i akuzuari ishte i
13 pranishëm gjatë keqtrajtimit që ka pasuar të shtënë me armë
14 bazohet vetëm në dëshminë e Dëshmitarit 1, që nuk mund të
15 mbështetet apo të konfirmohet për arsye që u përmendën dje nga
16 z. Gilissen dhe z. Aouini.

17 Të nderuar Gjykatës, dëshiroj tani të trajtoj disa
18 çështje që kanë të bëjnë me drejtësinë e kësaj apo trajtimit e
19 drejtë në këto procedura dhe ankesat e z. Shala lidhur me
20 këtë. Kjo është shtjelluar në mënyrë të gjerë në pjesën e
21 katërt të dosjes sonë përfundimtare. Sot do të përqendrohëm në
22 tre pika madhore kryesore.

23 Së pari, do të flas për padrejtësinë themelore që
24 rezulton nga përdorimi dhe mbështetja e mundshme në deklaratat
25 e bëra nga z. Shala në kushtet ku janë shkelur, cenuar të

1 drejtat e tij për të patur ndihmë ligjore efektive dhe që të
2 mos inkriminonte veten e tij. Pastaj do të flas për
3 padrejtësinë themelore të shkaktuar në këtë rast nga rrethanat
4 unike që kanë në fund të çështjes 8. Dhe përfundimisht dhe në
5 fund do të flas për shkeljet e të drejtave të z. Shala që të
6 ballafaqojë në mënyrë të duhur dëshmitarët kush janë kundër
7 tij.

8 Siç e dëgjuam dje, Prokuroria dhe Mbrojtësi i Viktimave
9 mbështeten fuqimisht në deklaratat e bëra nga z. Shala gjatë
10 katër intervistave në të cilat është marrë në pyetje nga
11 prokurë me përvojë dhe hetues me përvojë, fshirë prokurorë dhe
12 hetues të ZPS-së, pa u informuar paraprakisht dhe pa ju dhënë
13 ndihmë ligjore qoftë përpara apa gjatë intervistave.

14 Kjo ka të bëjë me intervistat e të akuzuarit të bëra
15 nga policia federale belge dhe ZPS-ja në 2016 dhe 2019, si dhe
16 dy intervista më të hershme të bëra nga Zyra e Prokurorit të
17 TPNJ-së. Trupi Gjykues ka pranuar transkriptet e TPNJ-së dhe
18 ka konstatuar, ka vlerësuar se transkriptet e belgëve dhe ZPS-
19 së nuk ishin të papranueshme.

20 Për të gjitha këto intervista, i akuzuari është marrë në
21 pyetje pa praninë e avokatit dhe pa ju dhënë mundësia që të
22 konsultohej me një avokat përpara marrjes në pyetje.

23 Në të gjitha këto intervista bëhej fjalë për pyetje,
24 çështje që ishin tejet inkriminuese të cilave i akuzuari u
25 përgjigjur.

1 Mbrojtja në mënyrë të vazhdueshme ka kundërshtuar
2 pranimin e këtyre deklaratave. Ne kemi në mënyrë të përsëritur
3 argumentuar se mbështetja e Trupit Gjykses në to do ta bënte
4 këtë procedurë të padrejtë. Pavarësisht kundërshtimeve,
5 pavarësisht pranimit nga Paneli i Trupit Gjykses të Dhomave të
6 Specializuara të Kosovës se e drejta e z. Shala që të ketë një
7 ndihmë ligjore efektive për qëllim, gjatë intervistës së vitit
8 2016 është shkelur, deklaratat edhe tani vazhdojnë të jenë në
9 dispozicion të Trupit Gjykses për marrjen e vendimit të tyre.
10 Siç e kemi parë, ato luajnë një rol kryesor në dosjen
11 përfundimtare të Prokurorisë fjalën e tyre përfundimtare.

12 Paneli i Apelit ka konfirmuar se marrja në pyetje e z.
13 Shala në 2016 është bërë në shkelje të qartë të standardeve të
14 ligjit për të drejtat e njeriut ndërkombëtare. Shkelja e të
15 drejtave të z. Shala gjatë kësaj interviste e bën përdorimin e
16 deklaratave inkriminuese në kontekstin e intervistës pasuese
17 pastaj në 2019 të palejueshme dhe të padrejtë. Po të ishte
18 bërë intervista e vitit 2016 në përputhje me ligjin,
19 përgjigjet e z. Shala në 2019 mund të kishin qenë krejtësisht
20 ndryshe, në veçanti po t'i ishte dhënë atij mundësia e
21 përfaqësimit ligjor për të cilën kishte të drejt.

22 Mënyra me të cilën ai është informuar për të drejtat e
23 tij gjatë kësaj interviste që është bërë në praninë e dy
24 zyrtarëve të ZPS-së, është shokuese. Z. Shala fjalë -- fjalë i
25 thotë dhe po citoj "Jeni informuar për të drejtat e tyre të

1 cilat jua kemi në duar. Janë ato të zakonshmet bla-bla-bla".
2 Të nderuar, kjo nuk mund, ju nuk mund të pranoni të nderuar
3 Gjykatës këtë mungesë flagrante të respektit për të drejtat e
4 të akuzuarit.

5 Doktrina e pemës dhe frytit të helmuar, të cilin ne e
6 kemi argumentuar në parashtrimet tona me shkrim lidhur me këtë
7 pikë, është konfirmuar nga Gjykata Evropiane e të Drejta të
8 Njeriut që përjashton deklarimin e deklaratave inkriminuese të
9 mëtejshme gjatë intervistës së 2019. Kjo është për shkak se
10 deklarata e vitit 2019 janë ndikuar në mënyrë thelbësore dhe
11 sepse janë bërë në kontekstin e intervistës së vitit 2016 e
12 cila ka shkelur të drejtat e z. Shala.

13 Prokuroria ka dështuar të tregojë se deklaratat e dhëna
14 vullnetarisht dhe në mungesë të një sjelljeje detyruese.

15 Çdo mbështetje e Trupit Gjykues për qëllime të
16 aktgjykimit të tij në deklaratat e marra në këto kushte të
17 cilat kanë mohuar të drejtat më themelore të Mbrojtjes do ta
18 bënte këtë procedurë gjyqësore të padrejtë dhe konstatimet e
19 bazuara në këto deklarata do të ishin të pasigurta.

20 Kemi dhe një problem tjetër që lidhet me këtë. Siç është
21 thënë në dosjen tonë përfundimtare, formulimi i qartë i nenit
22 46(h) të Ligjit, i lexuar së bashku me rregullën 138(1) të
23 Rregulloreve, kërkon që Trupi Gjykues të vendosë mbi
24 pranueshmërinë e provave. Kjo është bërë e qartë edhe nga
25 përdorimi i fjalës "duhet" do të përdorë në rregullin 138(1) e

1 cila mund të ishte që është ndryshe nga fjala "mund" që
2 gjendet në kornizën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

3 Ligji mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe
4 rregullorja të cilave ju referuam tani, kërkojnë nxjerrjen e
5 vendimeve mbi pranueshmërinë ashtu siç janë rregullat të cilat
6 ndiqen në procedurën përpara TPNJ-së dhe gjykatave të tjera,
7 mekanizmit, Tribunalit të Veçantë Special për Libanin,
8 Tribunali Special për Sierra Leone. Kjo është sepse palët kanë
9 të drejtën të kenë, të kuptojnë qartë dosjen e gjykimit në
10 përfundim të procedurave të paraqitjeve së provave.

11 Deri më sot, Mbrojtja nuk e di nëse Trupi Gjykues synon
12 të mbështetet në këto deklaratat. Heshtja e Mbrojtjes lidhur me
13 këtë çështje, siç e ka përmendur dhe ka thënë edhe Prokuroria,
14 tregon për dëmin e pësuar.

15 Trajtimi i këtyre deklaratave ishte aspekt themelor i
16 kësaj çështjeje dhe duhej të trajtohej. Pasiguria sa i takon
17 atyre që gjenden në dosjen e provave shkelë të drejtat e z.
18 Shala për të ditur me siguri cilat janë provat kundër tij dhe
19 të ketë mundësinë efektive për t'u përgjigjur kësaj, më së
20 fundi, në dosjen minimalisht për t'ju përgjigjur kësaj.

21 Së dyti, padrejtësia që buron nga vetë kjo dhe shkelja e
22 parimit të barazisë së armëve duke shkelur atë që ne e kemi
23 thënë, pushteti i Prokurorisë në rastin 8.

24 Dhe, të nderuar, me këtë do të kërkoja që të kalojnë në
25 seancë private.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

2 të na kaloni në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Avokate, mund të vazhdoni.

7 ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Faleminderit.

8 Po vijoj tani me pikën e fundit. Qartazi janë cenuar të
9 drejtat e z. Shala për t'u ballafaquar me dëshmitarët kundër
10 tij.

11 Dhe ka pasur një sërë problemesh me faktin që dëshmitë e
12 dy dëshmitarëve që anë shumë të rëndësishëm 2 dhe 4, ishin të
13 disponueshëm për të dhënë dëshmi para këtij Trupi Gjykes por
14 në të vërtetë u pranuan deklaratat e tyre me shkrim. Mbrojtjes
15 nuk ju dha e drejta t'i ballafaqonte dhe të vinte në
16 pikëpyetje dëshmitë e tyre. Kjo nuk ka qenë as e përligjur dhe
17 as e bazuar. Edhe kjo cenoi Mbrojtjen sepse nuk i dhanë
18 mundësinë të ballafaqohej në mënyrë që t'u bënte atyre të
19 qarta kontradiktat mes deklaratave të tyre të ndryshme.

20 Krahas kësaj, dëshmitë e dy dëshmitarëve kryesorë, 4733
21 dhe 1448, po ashtu janë pranuar me shkrim. Tani kjo mund të
22 duket e logjikshme, sepse ata kanë vdekur. Por kur bëhet fjalë
23 identifikimin dhe për faktin se për Dëshmitarin 4733 shkrimi
24 që ky person ka dhënë për të akuzuarin është tërë gabime dhe
25 1448 e ka identifikuar të akuzuarin bazuar në informacione që

1 ia kanë thënë persona të tjerë të pabesueshëm, ka pasur cenim
2 faktin që është pranuar dëshmia e tyre pa pasur ne mundësinë
3 t'i ballafaqojmë këta dëshmitarë dhe z. Shala nuk pati mundësi
4 rrjedhimisht t'i ballafaqonte dëshmitarët lidhur me dëshmitë
5 që ata kanë dhënë kundër tij.

6 Për të zgjidhur këtë cenim, Trupi Gjykues nuk duhet t'u
7 kushtojë rëndësi dëshmime të tyre dhe të mos pranojë asnjë nga
8 aspektet që nuk konfirmohet nga dëshmi të besueshme dhe të
9 rëndësishme.

10 Në vend që të pranojmë problemin e qartë lidhur me
11 dëshminë e Dëshmitarit 4733 lidhur me identifikimin tërë cene
12 që ka bërë për të akuzuarin, Prokuroria e ka përdorur këtë në
13 një shkallë të lartë. Dhe ka sjellë katër persona të tjerë që
14 lidhen me të që kanë përsëritur atë që ai u kishte thënë
15 këtyre katër personave.

16 Tani, këta personat e tjerë mund të jenë të bindur që ajo
17 që ka thënë Dëshmitari 4733 ka qenë e vërtetë. Madje edhe ky
18 vetë dëshmitar mund të ketë qenë i bindur për atë që ka thënë.
19 Por ama problemi qëndron që identifikimi që ka bërë për të
20 akuzuarin ishte i rremë. Z. Shala nuk është pothuajse "i zi",
21 dhe Mbrojtja nuk ka qenë në gjendje ta konfrontojë apo ta
22 ballafaqojë Dëshmitarin 4733 në lidhje me këtë.

23 Po ashtu Mbrojtja nuk ka qenë në gjendje të ballafaqojë
24 identifikim e rremë që kanë bërë dëshmitarët e tjerë sepse
25 këta dëshmitarë kanë ditur vetëm atë që u kanë thënë. Është

1 një cenim i qartë i procesit të drejt në një situatë të tillë
2 kaq problematike sepse ky informacion nuk është paraqitur një
3 herë por pesë herë dhe në rrethana kur Mbrojtja nuk pati
4 mundësi të ballafaqonte një informacion të tillë.

5 Këtu mbyll fjalën time dhe tani e merr fjalën z.

6 Gilissen.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 I jap fjalën z. Gilissen.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes.

11 Ky është moment i vështirë për Mbrojtjen. Sepse ka ardhur
12 momenti që të japim përfundimet lidhur me këtë çështje
13 gjyqësore. Është moment delikat dhe më shumë se kurrë është e
14 rëndësishme të jemi të saktë dhe të mos lejojmë gabime apo
15 keqkuptime.

16 Më duhet të them që kur dëgjova prezantimet dhe
17 argumentet e Prokurorisë, kam frikë se kjo na sjell disa
18 vështirësi. Dhe, në fakt, vështirësia e parë, pra, thelbi i
19 këtij procesi nuk është fakti a janë privuar persona nga
20 liria. Nuk e kontestojmë këtë pikë. Dhe a janë keqtrajtuar
21 këta persona. Po pyetja kryesore këtu, siç tha dhe z. Aouini,
22 është a ka qenë Pjetër Shala?

23 Ne duhet të këmbëngulim dhe të zbulojmë a ka marrë pjesë
24 ai apo jo në një veprim të tillë kriminal në arrestimin,
25 ndalimin dhe në kushtet sesi janë kryer këto ndalime. Z. Shala

1 është i qartë. Jo, kurrë, asnjëherë të vetme.

2 A mori pjesë ai në keqtrajtimin dhe dhunën ndaj këtyre të
3 ndaluarve? Jo, kurrë.

4 Dhe pyetja është: A është ai fajtor për vrasjen e një
5 prej këtyre të ndaluarve? Absolutisht jo.

6 Pra, mund të jetë një çështje shumë e thjeshtë kjo, siç
7 tha dhe vetë Prokuroria.

8 Po a ka qenë z. Shala pjesë e një sistemi që ishte
9 krijuar për të kryer këto krime? Vetë ai a i kreu krimet për
10 të cilat e akuzon Prokuroria? Jo, jo nuk i ka kryer. Kjo është
11 shumë e qartë. Dhe, nëse ju do dilnit me një konstatim tjetër,
12 nëse ka bërë një vepre penale, këtë e ka bërë si kryes apo e
13 ka bërë si bashkëpunëtor?

14 Dhe, në fund, nëse doni të thoni që z. Shala ka kryer
15 diçka në kundërshtim me ligjin, ne duhet të kuptojmë nëse kjo
16 vepër penale ka qenë e lidhur me krimet e kryera prej të
17 tjerëve apo ka qenë një vepre penale që lidhet vetëm me këtë
18 person dhe tërësisht individuale e lidhur me të.

19 Sikurse e dini, të nderuar Gjykatës, të gjitha format e
20 pjesëmarrjes penale kërkojnë më së paku një gjë: Të kesh
21 dijeni për situatën kriminale. Dhe vetëm, nëse vërtetohet që
22 personi ka dijeni në këto raste, është e nevojshme të
23 vërtetohet më së paku një akt që ilustron faktin që personi ka
24 marrë pjesë me dijeni të plotë në një situatë të tillë
25 kriminale, në një vepre penale.

1 Për të lidhur z. Pjetër Shala me krimet e atyre që janë
2 shpallur tashmë fajtorë për krimet që janë kryer në fabrikën e
3 metalit në Kukës në kohën e aktakuzës, Prokuroria është
4 mbështetur në deklaratat e disa dëshmitarëve që pretendojnë se
5 Pjetër Shala ka qenë pjesë e keqtrajttimeve dhe krimeve të
6 kryera ndaj këtyre të ndaluarve. Prokuroria ishte shumë e
7 bindur me tre nga këta persona, vetëm tre persona dhe
8 Prokuroria është bazuar në disa nga deklaratat e këtyre
9 personave dhe ka përjashtuar deklaratat të tjera që janë
10 lëshuar nga po këta dëshmitarë, sepse pjesë të tjera të
11 deklaratës nuk përputhen, nuk puthen me këtë plan.

12 Ata kanë zgjedhur çka i ka interesuar. Ne duhet të
13 kuptojmë si është situata. Pra, të mos harrojmë që mbështetur
14 në disa prej deklaratave të këtyre tri personave për të lidhur
15 Pjetër Shalën me të ndaluarit, Pjetër Shala u prezantua këtu
16 si një person që ka pasur përgjegjësi në Kukës. U tha se ka
17 qenë një nga udhëheqësit kryesor dhe personat ndër më të
18 rëndësishëm mes ushtarëve të paraqitshëm në Kukës. U prezantua
19 si një anëtar i rëndësishëm i Brigadës 128, ku paska qenë
20 bashkëpunëtor i Ruzhdi Saramatit.

21 Dhe bazuar në një deklaratë të vetme - deklaratë të vetme
22 - që nuk është konfirmuar në asnjë formë, u pretendua se ai
23 kishte kaq autoritet në atë vend sa mund të hynte e të dilte
24 lirisht në fabrikën e metalit të Kukësit pa i dhënë llogari
25 askujt. Kanë qenë me mijëra persona në fabrikën e metalit në

1 Kukës. Dhe këta persona kanë thënë, nuk e dimë nga ka ardhur
2 ky informacion.

3 Sepse ky informacion nuk është konfirmuar asnjëherë prej
4 askujt.

5 Është shumë e qartë që z. Shala ka qenë i stacionuar në
6 fabrikën e metalit të Kukësit dhe ka qenë duke ushtruar
7 autoritetin e tij tek ushtarët dhe ka marrë pjesë, thonë, në
8 marrjet në pyetje të dhunshme dhe në vendngjarje apo vend,
9 skena krimi ku përfshiheshin të ndaluar.

10 Ju do ju kujtohet besoj që Prokuroria ka pretenduar që
11 Pjetër Shala ka sulmuar Dëshmitarin 1 në 12 raste. Dhe kjo
12 është në transkript 6 qershor 2023, në faqen 1933. Thuhet 12
13 raste. Dhe Prokuroria ka besim tek dëshmitarët që e mbështesin
14 këtë prezantim të qartë dhe të saktë të fakteve sepse - sepse
15 - këtë qëndrim kanë pasur për gjatë shumë viteve - kjo është
16 deklarata e këtyre dëshmitarëve.

17 Po ne e dimë sot, të nderuar Gjykatës, që realiteti ka
18 qenë krejt ndryshe. Nuk ka qenë kjo e vërteta. Të gjithë ne e
19 dimë. Dhe Prokuroria e ndryshoi prezantimin e provave të veta.
20 Shala, pra, Pjetër Shala, z. Pjetër Shala nuk ka qenë
21 asnjëherë partner i Ruzhdi Saramatit në Brigadën 128. Ne e
22 dimë. Madje ai s'ka qenë pjesë e kësaj brigade. Asnjëherë të
23 vetme.

24 Shala, z. Pjetër Shala, s'ka pasur asnjë lloj
25 përgjegjësie apo autoriteti ndaj personave në fabrikën e

1 metalit në Kukës. Në asnjë moment të vetëm nuk është treguar
2 ndonjë provë në lidhje me këtë. Asnjë gjë e vetme.

3 Sot, në fakt, askush nuk vijon t'i qëndrojë më këtij
4 skenari dhe madje përpiqen dhe ta fshijnë dhe të thonë që
5 askush nuk e ka thënë ndonjëherë këtë. Në të vërtetë,
6 fatkeqësisht, Mbrojtja ishte në gjendje të vërtetonte që
7 Pjetër Shala nuk ka qenë asnjëherë anëtarë i Brigadës 128, por
8 ashtu vërtetoi se shumë, shumë pak persona nga ata një mijë
9 persona që kanë qenë në fabrikën e metalit në Kukës në gjashtë
10 mujorin e parë të 1999 e kanë parë Pjetër Shalën në këtë
11 fabrikë në periudhën e përcaktuar në aktakuzë.

12 Dhe ata pak persona që e kanë parë në fabrikën e metalit
13 në Kukës, e konfirmojnë se e kanë parë vetëm dy, tri, katër ja
14 pesë herë qameti dhe askush nuk ka thënë që e kam parë në
15 dhomat e ndalimit apo goftë edhe pranë dhomave të ndalimit.
16 Unë po pres të më thonë kush dëshmitar, kush e ka thënë këtë,
17 cili dëshmitar. Emrin. Numrin. Askush. Asnjë i vetëm.

18 Për më tepër askush nuk ka pretenduar se Pjetër Shala ka
19 pasur përgjegjësi apo kompetenca hierarkike në fabrikën e
20 metalit të Kukësit, askush nuk pretendon më që ai të ketë qenë
21 i vendosur, pra, i vendosur, në fabrikën e metalit në Kukës
22 apo goftë në qytetin e Kukësit.

23 Mbi të gjitha, është e qartë se veç këtyre tri
24 dëshmitarëve të njëjtë që akuzojnë z. Shala se ka kryer krime,
25 asnjë prej 18 personave që pretendon Prokuroria se kanë qenë

1 të ndaluar në Kukës, pra, në fabrikën e metalit, nuk e kanë
2 evidentuar ndonjëherë Pjetër Shalën si një prej kryerësve të
3 krimeve dhe z. Aouini ishte shumë i qartë për këtë, apo qoftë
4 dhe një nga personat që ta kenë parë gjatë ndalimit të tyre.

5 Askush nuk ta jep një përshkrim të personit që ngjasonte
6 me z. Pjetër Shala. Kjo është e habitshme, nëse duam të
7 kuptojmë saktësisht cilat janë provat e Prokurorisë.

8 Dëshmitarët okularë janë të bindur që nuk e njihnin z.
9 Shala, as nuk e kanë njohur z. Shala. As nuk e kanë dëgjuar
10 ndonjëherë emrin apo nofkën Shala apo Ujku përkatësisht.

11 Pra, asgjë apo pothuajse asgjë nuk na ka mbetur nga
12 skenari fillestar i Prokurorisë, por [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]. Po kjo është e rëndësishme.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos

1 duhet të kalojmë në seancë private?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po, po. Duhet të kalojmë në
3 seancë private. Ju kërkoj ndjesë. Ju kërkoj ndjesë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
5 lutem, të kalojmë në seancë private.

6 [Seancë private]

7 [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 Faleminderit.

18 Avokat fjala është ju.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

20 Pra, ju dhashë, ju tregova një histori të re, një histori

21 të re që e ka lëshuar ekipi i Prokurorisë kundër z. Shala, por

22 kjo histori e re është zhvilluar dhe më tej po dhe është

23 ndryshuar. Ka pasur ndryshime në deklaratën e këtij dëshmitari

24 për të fshirë informata dhe elementë të rinj që kanë dalë

25 gjatë procesit hetimor. Ju lutem shikoheni me vëmendje. Po

1 shihni datat.

2 Del një element i ri me një akt-ekspertizë dhe ndryshon
3 deklarata e dëshmitarit. Del një element i ri nga një
4 dëshmitar tjetër edhe ja ndryshon prapë deklarata e këtij
5 dëshmitari. Shihni datat. Po është e qartë. Shihni kur flet
6 për numrin e plumbave, numrin e të shtënave, pozicionin, ka
7 ndryshuar shumë gjëra.

8 Pra, si rezultat kemi disa versione të së njëjtës ngjarje
9 dhe me ndryshime detajesh dhe këtë e kemi me shembuj dhe këtu
10 bëhet fjalë se kush ka qenë i përfshirë, çfarë ka ndodhur,
11 çfarë armësh janë përdorur në vendngjarje. Dhe ju e dini edhe
12 emrin e personit që ka qëlluar. Unë ua thashë dje. Nuk është
13 nevoja ta përsëris, po mbase më mirë ta përsërisim ndonjëherë
14 që të mos lejojmë gabime. Edhe emri i personit që ka qëlluar
15 ka ndryshuar dhe jo vetëm një herë, as dy herë, tri herë.
16 Katër emra kemi të një personi që paska qëlluar.

17 Si rezultat, pra, thashë, kemi disa versione të një
18 njëjtës ngjarje dhe unë dua të bëj një pyetje: Kush ka qenë i
19 pranishëm në këtë vendngjarje? Ka ndryshuar shumë.

20 Dhe nuk është hera e parë që ky dëshmitar e ka ndryshuar
21 dëshminë e vet por -- mbase duhet ta kisha thënë diçka në
22 seancë private në fakt.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
24 rregull.

25 Kalojmë sërish në seancë private.

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi në seancë publike.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
9 keni fjalën ju përsëri, z. Gilissen.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Shumë faleminderit.

11 Mendoj se Dëshmitari 01 është i pabesueshëm, sepse ai
12 është bërë dëshmitar i pabesueshëm për shkak të dëshmime që ka
13 dhënë. Dhe nuk është se mund të merren si të besueshme
14 shpjegimet e tij për ndryshimin e dëshmime që ka dhënë
15 ndërkohë. Dhe, jo vetëm kaq, po ky dëshmitar i ndryshon edhe
16 arsyet se pse ai ka ndryshuar dëshminë e tij dhe shpesh herë
17 është kontradiktor me atë çfarë ka thënë më përpara.

18 Pavarësisht kësaj, të gjitha këto gjëra, Dëshmitari 1 i ka
19 bërë. Nuk ka hezituuar absolutisht që të vërë në pikëpyetje
20 cilësinë e punës së disa përkthyesve. Së dyti, po ashtu ka
21 nxjerrë në pah edhe korrektësinë ose jo të disa hetuesve. Dhe
22 gjithashtu për të vënë në pyetje edhe ndershmërinë e një
23 prokurori që e ka përmendur në dëshminë e vet. Dhe mendoj që
24 kjo është çështje shumë e rëndësishme, sikurse e përmenda dhe
25 dje. Sepse në qoftë se ka ndonjë element në procedurë,

1 sigurisht, që ne të gjithë, pra, duhet që këto probleme ose
2 defekte që duhet të ketë në procedurë të jenë në dijeninë
3 tonë.

4 Është mbresëlënëse për pyetur njëri prej kolegëve të
5 Prokurorisë që: Si është e mundur që një person ose një
6 dëshmitar e thotë një gjë të tillë kaq negative për një
7 kolegët e mi, për një prokuror tjetër? Domethënë, unë nuk e
8 imagjinoj dot. Domethënë, në qoftë se një dëshmitar ti e ke
9 nën betim edhe ai vazhdon e flet gjëra të tilla, minimalisht
10 duhet të bësh ca pyetje sqaruese të tjera. Ndërkohë që kolegu
11 i Prokurorisë, siç duket, nuk e kishte problem këtë gjë.

12 Të nderuar Gjykatës, e imagjinoni vetëm për çast, se
13 çfarë ju personalisht, vetë ju si Gjykatës të çështjes Shala,
14 çfarë do krijonit ju si përshtypje për z. Shala që nën betim
15 të ndryshonte dëshminë e vet? Në fakt, Dëshmitari 01 ka bërë
16 ekzaktësisht të njëjtën gjë. Ai e ka ndryshuar përmbajtjen e
17 deklaratës së vet disa herë, jo një herë përpara jush. Cila
18 është përmbajtja e dëshmisë së tij dhe çfarë ndodhë në
19 momentin kur nxirret në dritë informacion gjatë marrjes së tij
20 në pyetje që është në kundërshtim me informacioni që ai ka
21 dhënë më përpara gjatë hetimeve?

22 Në fakt, nuk ka ndodhur asgjë. Megjithatë situata e
23 komplikuar dhe problematike nuk ka përfunduar aty. Unë jua kam
24 thënë edhe më përpara që ky dëshmitar ka gënjyer e atë e ka
25 pranuar dhe vetë. [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR] Kjo gjithashtu
2 shpjegohet në hollësi nga dëshmia e 01 lidhur me vrasjen në
3 fjalë që rrëfimet e të cilit nuk janë në puthje me konstatimet
4 me opinionin dhe përfundimet e ekspertit.

5 Në fakt, ky dëshmitar thotë që vetë e ka parë me sytë e
6 veta vrasjen dhe që e ka parë personin e akuzuar, z. Shala që
7 të jetë i pranishëm aty. Ndërkohë dëshmitarë të tjerë që kanë
8 dëshmuar përpara jush nën betim ju kanë thënë që ky dëshmitar,
9 pra, Dëshmitari 01, nuk ka qenë në të njëjtën dhomë ku ka
10 ndodhur vrasja sepse në atë çast ai ka qenë me ata, pra, me
11 persona të tjerë që kanë dhënë dëshminë përpara jush, pra, ka
12 qenë i ndaluar në një dhomë tjetër dhe këtë nuk ua ka thënë
13 vetëm një dëshmitar, jua kanë thënë shumë veta.

14 Pse e them unë këtë gjë? Po e them sepse është e
15 rëndësishme që të kuptojmë konstatimet dhe opinionet e
16 ekspertëve dhe pse konstatimet dhe opinionet e tyre nuk
17 përkojnë me shpjegimet e dhëna nga Dëshmitari 01 i
18 Prokurorisë.

19 Pavarësisht se çfarë opinionin mund të kemi secili prej
20 nesh, ne nuk do e marrim vesh asnjëherë se çfarë ka ndodhur
21 realisht kur është qëlluar një herë ose disa herë viktimat
22 sepse Dëshmitari 01 ka gënjyer kaq shumë dhe e ka ndryshuar
23 kaq shumë deklaratën e vet sa ne asnjëherë nuk do e marrim
24 vesh të vërtetën.

25 Përsëri, çfarë do mendonit ju dhe çfarë përfundimi do të

1 nxirrnit në qoftë se z. Shala do t'ju gënjente qoftë edhe një
2 herë të vetme në shpjegimin apo në deklaratën e vet përpara
3 jush? Sigurisht, që ju duhet ta kishit deklaruar atë të
4 pabesueshëm dhe person jo të denjë dhe jam i sigurt që nuk do
5 kishit pranuar shpjegimet e dhëna prej tij dhe sigurisht, jam
6 i sigurt që do e kishit dënuar atë. Jam e sigurt për këtë gjë.
7 Dhe më duhet të them se në qoftë se do ishte z. Shala në këtë
8 situatë, kjo do ishte normalja.

9 Ajo çfarë po kërkoj unë dhe ajo çfarë kërkohet prej
10 ligjit dhe drejtësisë reale, është që të përdoren kriteret e
11 duhura të analizuar besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e
12 deklaratës, unë kërkoj që këto kritere të jenë të njëjta për
13 të gjithë, të jenë të njëjta për të gjithë pavarësisht në
14 qoftë se deklarata bëhet nga një i akuzuar apo nga një
15 dëshmitar, pra, kriteret duhet të jenë të njëjta për të
2 drejtë nga një krim që mund të dënohet i akuzuari. Ne mendojmë
3 që kjo është e debatueshme. Sepse në momentin kur Trupi
4 Gjykues të arrijë tek çështja e zhdëmtimit, i akuzuari të
5 paktën është dënuar për një krim. Dhe në këtë pikë i takon që
6 Trupi Gjykues të shqyrtojë ndikimin e këtij krimi mbi viktimat
7 dhe të marrë parasysh zhdëmtimet, pra, cilat zhdëmtime janë të
8 përshtatshme. Dhe sa i takon këtij propozimi, ne themi që kjo
9 thuhet shprehimisht në ligj dhe si rezultat nuk është e
10 nevojshme që të jepen shpjegime të tjera lidhur me këtë.

11 Në paragrafin 15 propozimi i dytë është që i akuzuari nuk
12 mund të mbajë përgjegjësi për zhdëmtim të dëmtimit të
13 shkaktuar në mënyrë jo të drejtpërdrejt prej tij për një krim
14 për të cilin ai do të dënohet. Ne mendojmë që një situatë e
15 tillë nuk ngrihet mbi fakte. Sepse nuk ka pretendim për dëmtim
16 që nuk është shkaktuar nga një krim për të cilin i akuzuari
17 nuk është akuzuar.

18 Megjithatë, duket sikur është e qartë që Mbrojtja
19 sugjeron që duhet të ketë një lidhje shkak-pasojë ndërmjet
20 *actus reus* të krimit që kryet nga i akuzuari personalisht ose
21 vetë nga ai. Dhe kjo qëndron në qendër të propozimit të tretë
22 që bëhet nga Mbrojtja, propozim i cili është si më poshtë: I
23 akuzuari as nuk mund të pritët që të zhdëmtojë dëmtimet e
24 shkaktuara nga krime ose veprime të kryera nga anëtarë të
25 tjerë të UÇK-së gjatë kohës përkatëse që përcaktohet në

1 aktakuzë. Ne parashtrojmë që kjo është në kundërshtim me
2 ligjin.

3 Ajo çfarë bën Mbrojtja është që jepet një skenar që synon
4 që të jetë në kundërshtim me propozimin 1 të cituar më sipër,
5 por, në fakt, ajo prezanton një tipar tërësisht të ri, pra, ky
6 tipar i ri janë: Krimet ose veprimet nga anëtarë të tjerë të
7 UÇK-së.

8 Ne parashtrojmë se përgjigja e shkurtër ndaj këtij
9 propozimi është si më poshtë: Varet nëse anëtarët e tjerë kanë
10 qenë bashkëkryerës ose si ato që i akuzuari ka ndihmuar ose ka
11 inkurajuar apo si pjesë e NKP-së apo në një mënyrë tjetër.

12 Në qoftë se të tjerët kanë qenë të përfshirë bashkërisht
13 me të dhe të qëndrojmë këtu për momentin tek përgjegjësia e
14 NKP-së, ne parashtrojmë që ligji është shumë i qartë. Anëtarët
15 e NKP-së ose në mënyrë të përbashkët janë të gjithë së bashku
16 përgjegjës për dëmet e shkaktuara si rezultat i krimeve të
17 kryera prej tyre.

18 Çështje Ntaganda citohet nga Mbrojtja, megjithatë citimi
19 është shumë përzgjedhës, domethënë, Mbrojtja ka zgjedhur ato
20 pjesë që i interesojnë asaj. Në fakt, dhoma gjyquese në
21 Ntaganda arriti në përfundimin që është tërësisht kundra
22 propozimit që është parashtruar nga Mbrojtja.

23 Do i kërkoja Sekretarit të paraqesë diapozitivin 23 për
24 palët. Faleminderit.

25 "... në parim, pyetja në qoftë se individë të tjerë mund

1 të kenë kontribuar tek dëmi si rezultat i krimit për të cilin
2 dënohet dikush nuk ka lidhje me përgjegjësinë penale të këtij
3 personi për zhdëmtimin e dëmtimit'. Për rrjedhojë, Dhomat e
4 gjykatës përkatëse kanë konstatuar që personi në fjalë është
5 përgjegjës për zhdëmtimin e masës së plotë të dëmtimit të
6 shkaktuar nga viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të të
7 gjitha krimeve për të cilat ata janë dënuar dhe jo vetëm roli
8 i krimit, roli që ka luajtur personi në fjalë për krimet edhe
9 për mënyrat e ndryshme të përgjegjësisë penale.

10 "Po ashtu, në rastin e çështjes kundër z. Ntaganda kemi
11 të bëjmë me përgjegjësi penale të bashkëndarë ndërmjet tij dhe
12 bashkëkryerësve të tjerë për krimet për të cilat ai është
13 dënuar, përfshirë edhe persona të tjerë, pra, përveç atij, të
14 cilët mund të kenë kontribuar tek dëmi i pësuar për viktimat.

15 "Sa i takon përgjegjësisë së bashkëndarë të z. Ntaganda
16 dhe kryerësve të tjerë në krime për të cilat është dënuar ai,
17 përfshirë këtu edhe z. Thomas Lubanga, Dhoma vëren se ata të
18 gjithë bashkërisht mbajnë përgjegjësi penale dhe duhet të
19 paguajnë zhdëmtimin e dëmtimeve të shkaktuara për viktimat.
20 Përgjegjësia në tërësi identifikohet nga ekspertët e caktuar
21 si një proces i cili korrespondon me të drejtën që të gjithë
22 personat bashkëkryes do të duhet që të plotësojnë ose të
23 përmbushin zhdëmtimin për dëmet e shkaktuara për personin në
24 fjalë, pra, për viktimat".

25 Për ata të cilët na dëgjojnë përtej Gjykatës, për t'ju

1 shpjeguar kjo shprehja "bashkërisht" do të thotë se ekziston
2 një përgjegjësi e bashkëndarë ndërmjet bashkëkryerësve të një
3 veprë të caktuar ose ndryshe siç quhet, pra, vepra "in
4 *solodum*".

5 Pra, në përfundim, ne themi që është absolutisht e
6 kundërt me atë çfarë parashtrohet nga Mbrojtja, pra, Mbrojtja
7 thotë që i akuzuari nuk mund të pritët që të paguajë zhdëmtime
8 për dëmet e pësuar në mënyrë të tërthortë apo të
9 drejtpërdrejt apo për krime të cilët janë kryer nga të tjerët.
10 Në fakt, nuk është rasti ky në qoftë se do i futemi analizës
11 të çështjes që unë citova më sipër.

12 Do kërkoja tani të kalojmë tek diapozitivi 24.

13 "Dhoma e Apelit rikujton se:

14 "Përgjegjësia e një personi të dënuar për zhdëmtime duhet
15 të jetë proporcionale me dëmin e shkaktuar dhe ndër të tjera
16 pjesëmarrja e tij ose e saj në kryerjen e krimeve për të cilat
17 ai ose ajo është gjetur fajtor në rrethanat konkrete të
18 çështjes në fjalë.

19 "Dhomat e Apelit më tej kanë konstatuar që gjetja e
20 mësipërme 'nuk do të thotë që sasia ose shuma e zhdëmtimit për
21 të cilat personi i dënuar ka përgjegjësi duhet të reflektojë
22 përgjegjësinë e tij apo të saj relative në raport me dëmin për
23 të cilin bëhet fjalë dhe në raport me personat e tjerë të
24 cilët kanë kontribuar për këtë dëm'. Dhoma e Apelit qartësoi
25 se në parim pyetja në qoftë se individët mund të ketë

1 kontribuar apo jo për dëmin që ka çuar në krime për të cilat
2 është dënuar personi është jorelevant për përgjegjësinë penale
3 të personit të dënuar për zhdëmtimin e këtij dëmi. Dhe
4 ndërkohë që një urdhër zhdëmtimi nuk duhet të tejkalojë koston
5 e përgjithshme të zhdëmtimit të dëmit, në vetvete, kjo nuk do
6 të thotë që nuk është me vend që personi që ka përgjegjësi të
7 mund të zhdëmtojë sasinë e plotë të dëmit të përcaktuar në
8 rastet përkatëse”.

9 Dua që t’ju tërheq vëmendjen gjithashtu edhe në vendimin
10 aktgjykimin për apelin në datën 8 mars 2021, që ka të bëjë me
11 urdhrin e zhdëmtimeve.

12 Në këtë urdhër miratohet qasja që neve, në fakt, e
13 paraqesim në diapozitivin 23 që e pamë përpara pak çastesh.

14 Në fakt, kjo e thekson këtë pikë, megjithatë nuk është se
15 ka të bëjë me argumentin në fjalë, në fakt, më duhet të them,
16 që ligji në vetvete shkon përtej kësaj.

17 Sepse në çështjen Katanga, i akuzuari u gjet përgjegjës
18 për dëme për të cilat ishin shkaktuar nga njerëz të cilët nuk
19 ishin fare pjesë e NKP-së. Pra, ishin persona të tjerë të
20 cilët kanë marrë pjesë në një sulm që nuk ishin pjesë e NKP-së
21 me të akuzuarin, me Katanga. Dhe pavarësisht kësaj, këta
22 persona janë konstatuar se duhej që të mbulonin zhdëmtimet e
23 dëmit. Kjo jepet në paragrafin 166, pra, në këtë rast personat
24 në fjalë është vendosur që të mbulojnë të gjithë sasinë ose të
25 gjithë shumën e dëmeve të shkaktuara për viktimën.

1 Kështu që ne themi që në paragrafin 15 dhe në
2 parashtrimin ose propozimin e tretë të bërë nga Mbrojtja,
3 parashtrimi ynë është që shpjegimet e dhëna nga Avokati
4 Mbrojtës ose nga Mbrojtja e të akuzuarit nuk janë të sakta.

5 Në qoftë se do të ndalojmë së menduari pak për këtë, më
6 duhet të them që është një propozim i ligjit në raport me
7 zhdëmtimin dhe ka të bëjë me bazën për NKP-në në vetvete. NKP-
8 ja, në vetvete, aktorët bëhen përgjegjës për aktet ose
9 veprimet e njeri-tjetrit ose për ato çfarë ata kryejnë, sepse
10 qëllimi i tyre është i përbashkët. Pra, ata synojnë që të kenë
11 një qëllim të përbashkët. Kështu që nuk duhet të vijë si habi
12 që kur flitet për zhdëmtimet, zhdëmtimet nuk është se janë të
13 hapura vetëm ndaj individit të caktuar, se individi i caktuar
14 nuk mund të thotë që "Unë kam shkaktuar këtë aspekt të dëmit
15 po jo këtë aspekt të dëmit". Sepse në të kundërtën ligji apo e
16 drejta në vetvete do bëhej absurde, kështu që, me respekt,
17 neve parashtrojmë që, në fakt, kjo nuk duhet të ndodhë as
18 këtu.

19 Kaq kisha për të thënë sa i takon ligjit deri tani si dhe
20 sa i takon aktorëve të tjerë ose përfshirës ose jo të tyre.

21 Më lejoni gjithashtu që të shtoj këtë pikë. Në paragrafin
22 21 të parashtrimit të Mbrojtjes thuhet se:

23 "Aktet e përshkruara më sipër të cilat pretendohet që të
24 kenë rezultuar në dëmin fizik të Dëshmitarit 1 këto nuk janë
25 kryer nga i akuzuari. Nuk është dëshmuar që këto janë akte që

1 janë kryer nga i akuzuari. Ato mund të jenë kryer nga anëtarë
2 të tjerë të UÇK-së në fabrikën e metalit në Kukës, veprimet
3 ose mosveprimet e të cilave nuk përfshijnë përgjegjësinë e të
4 akuzuarit".

5 Unë, në fakt, e ceka pak më sipër dhe pjesërisht e kam
6 trajtuar këtë propozim të Mbrojtjes sepse këtu po bëjmë fjalë
7 për akte të përbashkëta penale. Megjithatë sa i takon
8 propozimit që i akuzuari nuk ka kryer asnjë nga aktet në
9 fabrikën e metaleve në Kukës, që është një temë që del herë
10 pas here në parashtrimet e Mbrojtjes, ne parashtrojmë me
11 respekt si më poshtë: Pra, në këtë fazë nuk është fare e
12 rëndësishme, pra, domethënë, për aq kohë sa vërtetohet që
13 është kryer krimi. Pra, në qoftë se Mbrojtja thotë që i
14 akuzuari nuk është fajtor. Domethënë, nuk është e rëndësishme
15 çfarë thotë Mbrojtja, nuk është e rëndësishme çfarë thotë
16 Prokuroria ose çfarë themi neve. Sepse jemi përtej argumentit.
17 Dhe parashtrimi i përsëritur që i akuzuari nuk është fajtor
18 sepse nuk ka kryer asnjë prej këtyre akteve, në këtë fazë
19 shkon përtej diskutimit.

20 Tani më lejoni të trajtoj çështjen e dëmit material
21 lidhur me dy prej viktimave të kësaj çështjeje, do ju kërkoja
22 të nderuar Gjykatës që të kalojmë në seancë private për të
23 mbrojtur identitetin e viktimave.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, Avokat i Viktimave.

1 Ju lutem, Sekretar, na kaloni në seancë private.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjalë
4 e keni ju, Mbrojtës i Viktimave.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Pika e fundit që desha të trajtoj
6 është paragrafi 16 i përgjigjes së Mbrojtjes, ku sugjerohet se
7 shuma e pretenduar e kërkuar nga ne lidhur me dëmin që është
8 shkaktuar është "e tepërt dhe e disproporcionuar".

9 Me një përjashtim që shpenzimet mjekësore këtu i
10 përmendëm dhe në të cilin nuk mbështetemi, Mbrojtja nuk ka
11 bërë ndonjë përpjekje për të trajtuar vetë shumën apo shumat.
12 Nuk janë përpjekur fare të shpjegojnë apo të argumentojnë sesi
13 qasja jonë apo arritja tek shuma e caktuar është e gabuar apo
14 sesi shumat përfundimtare nuk janë në përputhje me situatat e
15 tjera të krahasueshme.

16 Në fakt, sa i takon dëmit material lidhur me Dëshmitarin
17 1, shuma që ne propozojmë është shumë modeste që edhe e
18 krahasuar me vlerësimin e ekspertit të Mbrojtjes është shumë
19 më pak se gjysma e asaj shume. Më pak se gjysma e shumës që
20 eksperti i Mbrojtjes quan si shumë të arsyeshme, në qoftë se
21 do të nxirret një urdhër për zhdëmtim që pasqyron dënim
22 material që ka pësuar Dëshmitari 1.

23 Dhe ne, qëndrimi jonë është që në mënyrë të qartë nuk ka
24 përpjekje për së shpjeguar cila duhet të jetë shuma, në fakt,
25 shuma e vërtetë? Siç thotë Mbrojtja duhet të jetë më e ulët se

1 ajo e pretenduar sepse janë të tepërta e të disproporcionuara.
2 Atëhere cila është shuma e drejtë e saktë? Dhe në çfarë, pse
3 në çfarë baze propozohet një shumë më e ulët?

4 Qëndrimi jonë është që shumat tona dhe, në veçanti, në
5 çdo çështje përputhen me shumat që janë vendosur dhe caktuar
6 si të duhura në urdhrin për zhdëmtim në çështjen Mustafa. Dhe
7 hedhim poshtë pretendimin që këto qenkan në një mënyrë apo
8 tjetër të tepërta apo të disproporcionuara dhe qëndrimi jonë
9 është që arsyeja pse nuk është bërë përpjekja për të propozuar
10 shuma alternative është sepse shumat janë të proporcionuara,
11 të justifikuara dhe të drejta.

12 Këto ishin parashtrimet që kisha për të bërë lidhur me
13 zhdëmtimet. Faleminderit.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit, Mbrojtës i Viktimave.

16 Tani është koha t'i drejtohem Mbrojtjes për paraqitjen e
17 tyre, deklaratës së tyre, fjalës së tyre përfundimtare lidhur
18 me zhdëmtimet.

19 Fjalën e keni ju, Avokat Mbrojtës.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Sa të vendos
21 pajisjet që të jem gati. Faleminderit shumë, e nderuar
22 Gjykatëse.

23 Sa u përket zhdëmtimeve i akuzuari bëjmë të qartë njëherë
24 e përgjithmonë: Mbrojtja e z. Shala e respekton dhimbjen dhe
25 vuajtjen që kanë pësuar njerëzit. Dhe parimi i kompensimit për

1 dëmin e pësuar si rezultat i kryerjes së një vepre, një apo më
2 shumë krimi, nuk mund të kundërshtohet apo të vihet në
3 pikëpyetje.

4 Por, natyrisht, ky parim në çdo -- parimi siç do formë
5 zhdëmtimi e dëmi duhet të vërtetohet që është shkaktuar nga në
6 personin në kohën e kryerjes së veprës penale. Ne kemi
7 konstatuar që pretendimet në përgjithësi, jo të gjitha, por
8 përgjithësisht nuk shoqërohen me asnjë dokument mbështetës apo
9 që justifikon këtë.

10 Ka patur raste kur janë dhënë shpjegime lidhur me humbjen
11 por janë të bazuara në supozimet e pajustificuara apo
12 projektimet e pamundura. Si mendoni ju që njerëzit janë ndjerë
13 ata që ktheheshin nga kampet e përqendrimit?

14 Unë kam patur njerëz në familjen time që janë kthyer nga
15 kampet e përqendrimit në Belgjikë kur janë mbajtur të ndaluar
16 në këto kampe në Gjermani dhe për ata ka qenë, natyrisht,
17 shumë e vështirë, por kanë qenë të detyruar që të kthehen në
18 punë. Ishte kohë tjetër, jemi dakord. Por ky është realiteti.
19 Pra, është gjë shumë e vështirë që të detyrohesh të menaxhosh
20 dhe të ndash cila është pjesa e dëmit, në qoftë se ka dëm dhe
21 cila është zgjidhja e disa njerëzve që vendosin apo vlerësojnë
22 që duhet të mos punojnë më.

23 Dhe situata, gjendja e Dëshmitarit 1, pashë që kjo
24 paaftësi për të shkuar në punë nuk ishte paaftësi për të
25 shkuar në kafe, në dyqan apo për plazh apo për t'u takuar me

1 njerëz. Gjërat janë delikate. Nuk dua të them që s'ka asgjë.

2 Unë dua të them që duhet të jemi të kujdesshëm në momentin që
3 trajtojnë këtë çështje.

4 Besoj që i kemi shtjelluar gjerësisht vërejtjet dhe
5 komentet tona lidhur me këtë pikë në fjalën tonë përfundimtare
6 dhe mund t'i referohemi kësaj që kemi parashtruar që të mos
7 bëjmë përsëritje. Megjithatë, më duket që këto mund të
8 plotësohen me disa mendime të përgjithshme që kanë të bëjnë me
9 ndonjë proces zhdëmtimi në urdhrin që kërkohet.

10 Ky mendim apo reflektim frymëzohet nga parimi themelor që
11 nuk duhet të harrohet kurrë që është pasojat e efektit të
12 dëmit të kohës. Po i referohem ligjit të entitetit. Pra, është
13 ligji i termodinamikës, që zbatohet ndaj të gjithëve dhe i
14 përfshin edhe qeniet njerëzore. Ë shumë e thjeshtë. Natyrisht
15 gjërat, çdo gjë që është e organizuar ka tendencë që është e
16 përbërë që të shpërbëhet dhe ç'bëhet.

17 Entropia e lejon dhe shkakton që gjithçka të mblakët apo
18 të prishet e të vjetrohët.

19 Dhe nuk ka arsye pse të ketë kompensim për gjëra që do të
20 kishin humbur gjithsesi, pra, që të kompensohen gjërat që me
21 kalimin e kohës do të kishin humbur. Ju falënderoj. Nuk kam
22 tjetër gjë, nuk kisha tjetër gjë për të shtuar.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit, z. Avokat.

25 Tani i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave.

1 A dëshironi të përgjigjeni në parashtrimet e Mbrojtjes?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Atëherë e keni fjalën ju.

5 Z. LAWS: [Përkthim] Së pari, për pjesën më të madhe për
6 të cilën fola, u përqendrova tek ligji, nëse është e saktë dhe
7 nëse është e saktë apo jo që i akuzuari duhet të mbahet
8 përgjegjës për veprimet e tija si bashkëkryerës, për veprimet
9 e bashkëkryerësve të tij në ndërmarrjen e përbashkët
10 kriminale. Dhe përveçse, në qoftë se ka ndonjë ligj tjetër të
11 termodinamikës, nuk mendoj që dëgjova ndonjë përgjigje lidhur
12 me këtë pjesë të parashtrimit tim që trajton pohimin e
13 përsëritur në parashtrimin e Mbrojtjes që është se i akuzuari
14 nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet e të tjerëve.

15 A po përpigemi të themi këtu që Mbrojtja pajtohet me
16 këtë? Sepse do të na ndihmonte, unë kam bërë parashtrime e
17 tij. Dhe nuk marrë përgjigje për këtë. Dhe kjo është arsyeja
18 që nuk doja të thoja asgjë sot pasdite. Sepse jam në
19 vështirësi t'i kundërpërgjigjem kësaj sepse më duket që është
20 paraqitur një argument kundër kësaj.

21 Kështu që ftoj Gjykatën që thonë: Ta qartësojmë tani.
22 Është thjesht mosveprim apo gabim apo pajtohen që ligji siç e
23 kemi sugjeruar ne lidhur me përgjegjësinë të akuzuarit për
24 veprimet e të tjerëve në NKP?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit, Avokat.

2 Ia lej këtë Avokatit Mbrojtës që të bëjë apo të mos bëjë
3 veprim lidhur me këtë saktësim.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Besoj që më mirë është të
5 dëgjojmë znj. Cariolou lidhur me këtë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
7 jemi në komentet e Mbrojtjes mbi reagimet e Mbrojtësit të
8 Viktimave.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ajo që doja të thoja, dua të them
10 që kolegu im e ka bërë punën e tij shumë mirë, nuk po e qortoj
11 as nuk po korrigjoj asgjë të tijën.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Do të thoja diçka më shumë. Ftoj
13 Gjykatën që të qartësojë pozitën e Mbrojtjes. Po desha të them
14 diçka tjetër në lidhje me ligjin në qoftë se mundem.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
16 keni fjalën, vazhdoni.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Sa i takon kërkesës tonë për zhdëmtim
18 dhe sa i përket faktit që kjo kërkesë nuk shoqërohet me
19 dokumente mbështetëse, a mund t'i kujtoj Gjykatës raportin e
20 Dr. Lerz që është një analizë e argumentuar hollësisht e
21 qëndrimit sa i takon dëmit material lidhur me dy dëshmitarët,
22 Dëshmitarin 1 dhe 4733. Dhe nuk do të hyjmë në këto hollësi.
23 Ju e keni dokumentin. Dhe besoj që ju nuk pajtoheni fare me
24 këtë pohim që pretendon që ne nuk e kemi argumentuar qëndrimin
25 tonë. Ne e kemi argumentuar atë duke ju referuar qëndrimin të

1 Kosovës dhe të Gjykatës Supreme në Kosovë, udhëzimeve të saj
2 për zhdëmtim. Kemi argumentuar atë lidhur me provat që janë
3 vënë përpara kësaj Gjykate. Dhe e kemi argumentuar këtë dhe në
4 çështjen Mustafa edhe përpara disa gjykatave të tjera.

5 Dhe besoj që, kam frikë që nuk do të pajtohem me z.
6 Gilissen lidhur me këtë.

7 Për sa i përket zgjedhjes, vendimi për të mos punuar. Nuk
8 do të përsëris vështirësitë fizike që Dëshmitari 4733 ka patur
9 apo vështirësitë psikologjike, por është e qartë, ky është
10 qëndrimi, që nuk ishte vendimi i tij apo e zgjidhja e tij që
11 të mos punonte. Dhe e njëjta gjë vlen në të njëjtën mënyrë për
12 Dëshmitarin 1. Këta nuk janë persona që e kanë thënë në një
13 moment "ndoshta po të mos punoj fare, do marrë ndonjë ditë
14 zhdëmtim". Në atë kohë nuk patur asnjë ide që një Gjykatë si
15 kjo këtu do të kishte në të ardhmen mundësi dhe pushtet për të
16 urdhëruar zhdëmtimin në mënyrë që ata të mos punonin nga ai
17 moment. Pra, nuk është se kanë qenë dembelë dhe që dëmi tyre
18 financiar është shkaktuar nga dembelizmi i tyre. Është për
19 shkak të keqtrajtimit të rëndë që kanë pësuar nga i akuzuari
20 dhe të tjerë.

21 Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Mbarova.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

1 mund të dëgjojmë komentet e Mbrojtjes.

2 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Faleminderit. Ndoshta vetëm një
3 sqarim që kërkohet këtu.

4 Kur kemi deklaruar faktin e dukshëm që z. Shala nuk mund
5 të mbahet përgjegjës apo të urdhërohet që të zhdëmtojë dëmin e
6 bërë nga të tjerë, ne e kishim fjalën të tjerë që nuk mund të
7 përfshihen si bashkërisht përgjegjës. Dhe besojmë që kjo
8 sqaron qëndrimin tonë. Faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka
10 komente të tjera nga kjo anë e Mbrojtjes?

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Që të korrigjojmë diçka në
12 transkript. Kur z. Gilissen ju referua parashtrimeve tona në
13 dosjen përfundimtare, në fakt ishte përgjigje ndaj kërkesave
14 për zhdëmtim dhe besoj që të gjithë e kuptuan ishin
15 parashtrimet tona.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit për këtë shtesë.

18 Avokat Mbrojtës, a përfundojnë këtu komentet dhe
19 ndërhyrjet tuaja, z. Avokat?

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani
22 kemi mbërritur në pikën ku mund të bëhen pyetje nga anëtarët e
23 Trupit Gjykses.

24 Do të konsultoj kolegët e mi, në qoftë se kanë diçka.

25 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
2 ka pyetje nga Trupi Gjykses.

3 Në këtë moment dua t'i drejtohem të akuzuarit dhe ta pyes
4 nëse pohon qëndrimin e tij që dëshiron të ushtrojë të drejtën
5 e tij sipas nenit 135, paragrafi 4 i Rregullores për t'u
6 shprehur.

7 Z. Shala, a konfirmoni që dëshironi t'i drejtoheni Trupit
8 Gjykses dhe që të jeni personi i fundit që flisni siç ka thënë
9 edhe Avokati juaj?

10 I AKUZUARI: I nderuar, më falni a duhet të ngrihem apo? A
11 duhet të ngrihem në këmbë?

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet
13 të ngriheni në këmbë dhe pastaj -- tani e keni fjalën ju, z.
14 Shala.

15 I AKUZUARI: Unë kisha shumë për të thënë, po shumicën e
16 fjalëve i shprehën Avokatët e mi dhe i falënderoj shumë. Kanë
17 ngelë disa gjena për t'i thënë. Besoj që do të jem i qartë.

18 Unë e di që do t'i përgjigjem ma së pari zotnisë,
19 Avokatit të Viktimave, që tha, e mora shënim sot, tha ka
20 humbur punën në 2008. Këtu do të thotë lufta nuk ka përfunduar
21 në 2008 që ai të humbte punën. Lufta ka përfunduar në 1999. Do
22 të thotë punoi deri në 2008. [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]. Dhe ajo e ka

25 rreziku jo unë as kurrkush tjetër.

1 Sa përket Dëshmitarit 4733, tani a ishte i pensionuar ky
2 apo ishte në punë? Se mu duk se thatë z. Prokuror që ky person
3 ishte i pensionuar në vitin 1997. Tani në qoftë se ishte i
4 pensionuar, i pensionuari nuk duhet të kthehet në aktivitet
5 pune, vetëm në gjendje lufte dhe lufta kishte përfunduar. Edhe
6 këtij na damin nuk ia banë as Ushtria Çlirimtare, as unë.
7 Këtina ju tërhoq shteti tina që e kishte, Serbia, u tërhoq nga
8 Kosova, ky humbi vendin e punës. Është më se e saktë.

9 Tani, që duhet t'i kompensojmë viktimat? Po, çdo viktimë
10 duhet kompensuar. Jam plotësisht dakord.

11 Po më së pari duhet të caktohet cila viktimë. Në qoftë se
12 luajmë loto, duhet të kemi një tiketë që kam luajt. Apo të
13 shkoj në gishi të them i dua 100 e ca euro milioni që i kishte
14 pse se unë mendoj që kam fituar po s'e kam asnjë tiketë, nuk
15 kam luajt, nuk kam tiketë. Dhe thotë që ka pas mjekim dhe s'ka
16 asnjë tiketë. Në çfarë shekulli jetojmë? S'ka, nuk mund të
17 bëhet një mjekim në botë po s'e ka një copë letër se ku është
18 mjeku, çka është mjeku, në botë, mendoj, se as në Kosovë.

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] S'ma merr

17 mendja. Unë vetëm mendoj që duhet t'i thirrni logjikës dhe ta
18 shihni sa e vërtetë ka, sa ka vërtetësi këtu. S'du të hyj më
19 thellë.

20 Mu jeta më është shkatërruar. Kam pas, mu duk se sot, po
21 ndoshta mund të ketë qenë lapsus përkthimi, se tha Prokurori i
22 paftyrë për mua, u duk. Tani nuk e di a lapsus përkthimi se më
23 siguruan avokatët e mi, avokatët e mi më siguruan më thanë në
24 anglisht nuk tha ashtu. Unë kërkoi falje, po në shqip më erdhi
25 i paftyrë. I paftyrë do të thotë i pamoral. Nuk e di se dikush

1 më ka dënu për një vepër amorale ndonjëherë në botë. Kam 61
2 vjet dhe i amoralshëm nuk kam qenë.

3 Jeta. Kam pas një jetë të thjeshtë. Të thjeshtë, shumë të
4 thjeshtë. Po mu shkatërroua. Kemi kenë persona të respektuar në
5 komunitetin shqiptar kudo. Bashkëshortja ime dhe unë, që më
6 dhimet shumë, që mbas kësaj tragjedie ka pësuar dhe nuk ka
7 nevojë t'i them në publik këtu se çka ka pësuar. Se i dini ju
8 fort mirë që i keni dokumentet.

9 Unë nuk e di çka duhet të paguaj? Për çka duhet të
10 paguajë? Dhe t'i besojmë këtij dëshmitari kur ma bën -- mund
11 ta them në publik thotë Hashim Thaçi ka qenë shofer i Pjetër
12 Shalës. Ministri i Mbrojtjes, Azem Syla, truproja ime. Unë
13 mund t'ju garantoj se Hashim Thaçi as nuk ma merr mendja se ka
14 patentë shoferi. Dhe tani duhet t'i besojmë këtij dëshmitari?

15 Unë nuk e di. Nuk kam shumë për të fol. Unë nuk e di se
16 nuk jam jurist, nuk kam kry fakultet juridik për t'i thënë
17 këto gjena, për t'i kuptu këto gjena, pra, me ti zënë besë
18 Prokurorit që ju sugjeron ju, ju thotë -- nuk duhet të merren
19 parasysh asgjë çka vjen nga dikund nga një seancë gjyqësore
20 tjetër, vetëm këtë çka ju prezantoj unë. Prokurori, sikur
21 inteligjencës artificiale sikur ta prezanton këto prova të
22 cekta edhe atë do ta hutonte, jo një njeri nga mishi dhe gjaku
23 siç jeni ju dhe unë e të tjerë të gjithë këtu.

24 Kemi kërku se mu në këtë sallë është dhënë një dëshmi në
25 procesin 06, është dhënë një dëshmi që është shfajësuese, për

1 mu, total. E kemi kërku, na e kanë dhënë. Po mund t'jua tregoj
2 se çka mund të lexoni ju në të. Qe. A mund të lexoni gjë?
3 Krejt është zi. Është shfajësuese. Po, këtu është zi krejt.

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 Unë nuk e di tash, nuk jam shumë inteligjent, të nderuar,
14 se po t'i kishna pas atë pozitë qysh preferojnë të më thojnë
15 këta, unë nuk do të kishna pastru rrugë. Kam fshi rrugët e
16 Belgjikës pesë vjet. Kam punu në komunën time pesë vjet. Dhe
17 jam krenar për atë se kam arrit t'i edukoj fëmijët, t'i
18 shkolloj fëmijët me atë mund çka kam pas. E tani të merrem me
19 të çue Hashim Thaçi, kryeministri i asaj kohe, kryeministri i
20 Qeverisë së Përkohshme shofer i imi. Ministri i Mbrojtjes,
21 truproja ime. Ja kredibiliteti i këtina ku duhet me kanë.

22 Prapëseprapë edhe një gjë tjetër s'kam qare pa e thënë.
23 Nuk i kem dëmtu këta persona. As nuk i kam vu në rrezik. Po
24 dua t'ju them, Milovan Drecun e thotë fjalë për fjalë: Falë,
25 thotë, kurajës, guximit të njerëzve tanë dhe pikëpamjes tonë

1 kemi arrit që t'i çojmë në Hagë të gjithë kriminelët
2 terroristë në UÇK-së, thotë. Tani merrni me mend fjalët e
3 tina, i ka thënë në parlament, pa asnjë dinar, thotë: Nuk kemi
4 shpenzu asnjë dinar falë kurajës së njerëzve tanë. Kush janë
5 njerëzit e tina? Unë veç bëj pyetjen kush janë njerëzit e
6 tina? A duhet tani të shpërblehet se përderisa nuk ka paguar
7 ai në atë kohë duhet me u pagu tash dikush tjetër.

8 Në rregull. Unë nuk e quaj askënd, nuk muj t'i them
9 askujt se është punëtor i tina apo i atina se s'kam provë.

10 4733, [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 Unë nuk e di tani çfarë faji kam unë prej 1999 që këta
16 persona nuk kanë punu. [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]. Se as nuk e kam ditë kush

22 është. Unë mund t'ju betohem.

23 Se edhe Prokurori tha që e ka ditë më herët. Ju betohem
24 jua kam thënë edhe hetuesve që nuk kam ditë deri në 2016 se a
25 kanë i vdekun. Pse? Se nuk kam përcjellë rastet. Nuk kam pas

1 mundësi t'i përcjelli se satelit mund ta vërtetoni se nuk kam
2 pas satelit në shtëpi teme. Nuk e kam pas të instaluar fare.
3 Edhe nuk kam pas ku me e dit kur kam punu gjithë ditën dhe në
4 mbrëmje jam kanë në shtëpi.

5 Me i thënë që i kam shku për çdo vjet unë atje edhe kam
6 marrë vesh në Kosovë që ku mbahen gjykatat, çka po mbahen, çka
7 po bëhet. Jo, s'kam kenë në dijeni.

8 E kam ndëgju që a dënu, po për çka tek, nuk kam dëgjue.
9 Po, kam dëgju që janë dënu njerëzit, po për çka, tek kanë,
10 çka, kush a kanë viktima dhe digje ma tepër s'kam dit. Marrja
11 në pyetje në 2016, ishte për trafikim organesh, për gjana të
12 tmerrshme.

13 Po, kam thënë se ia kam dhënë do shuplaka këtyne. Po, se
14 e pranoj kam thënë publikisht. Dhe nuk jam prej atyne që i iki
15 që ia kam dhënë do shuplaka. Po ia kam dhënë do shuplaka kur
16 më kanë thënë se kush janë, çka janë tu bë. Dhe me e mbrojt
17 fytyrën time dhe të tyren, ia kam dhënë do shuplaka dhe kam
18 shku në punë teme. [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 Unë nuk muj them se jam engjëll. Jo, jo s'jam engjëll. Po
9 për këtë çka ju tentoni me ma ngarkue zero lidhje kam, asnjë
10 lloj përgjegjësie të thjesht më të voglën s'e kam. As nuk kam
11 pas njohuri.

12 Pra, jetën time, dy fëmijët i kam me ilaçe, shopen me
13 ilaçe, jetën time ma shkatërruat, ju falënderoj për drejtësi
14 që jeni tuj vu në vend dhe drejtësi që doni të tregoni botës.
15 Ju falënderoj.

16 Unë kaq kam. E nderuar Gjyqtare, jeta ime është duart e
17 juaj. Nuk jam që kërkoj mëshirë, po kërkoj të gjykoni drejtë
18 logjikisht. Nuk kërkoj mëshirë se s'kam bë gjë për të kërkuar
19 mëshirë. Në qoftë se duhet dënu dikush se ka marrë pjesë në
20 luftë, janë 16.000 persona që mund t'i merrni sikur mu këtu.
21 16.000 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare mund t'i bini këtu për
22 përgjegjësi, siç thotë ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Në
23 qoftë se ju duhet me i marrë 16.000 ju urdhoj i merrni
24 16.000. Ne tani jemi në duar e juaja. Ju jeni për të dhënë
25 drejtësi botës dhe t'i tregu Kosovës se ja këtu është

1 drejtësia dhe në qoftë se a kështu drejtësia i paralajmëroj të
2 gjithë ata 16.000 ushtarë të ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
3 minimumi që janë, që secilin do ta gjejë sikur mue. Në qoftë
4 se duhet kështu secilin do ta gjen sikur mue.

5 Ju falënderoj. Unë kaq pata.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë atëherë.

8 Përpara se ta mbyllim seancën e ditës së sotme, u
9 drejtohem palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave për t'i pyetur
10 nëse kanë ndonjë gjë që duan ta shtrojnë këtu.

11 Prokuror?

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të
13 parashtuar.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mbrojtësi i Viktimave.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të parashtuar.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Avokat.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të
20 parashtuar.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
22 atëherë. Ju faleminderit.

23 Atëherë e deklaroj këtë çështje gjyqësore të mbyllur në
24 përputhje me rregullën 136 të Rregullores së Procedurës dhe
25 Provave. Në përputhje me Rregulloren, nuk mund të bëhen më

1 parashtime dhe nuk mund të dorëzohen më prova, me përjashtim
2 të rrethanave të jashtëzakonshme dhe kur paraqiten arsye të
3 vlefshme për këtë. Këtu nuk përfshihen aspekte që kërkojnë
4 rishikim të rregullt, siç është rasti i rishikimit të
5 paraburgimit të z. Shala.

6 Në emër të këtij Trupi Gjykses, falënderoj palët,
7 Mbrojtësin e Viktimave për kontributin e tyre, për ndihmën e
8 tyre dhe pjesëmarrjen e tyre në këtë Gjykatë. Falënderoj
9 përkthyesit, stenografin, sigurinë, të gjithë punonjësit që na
10 kanë ndihmuar këtu në sallën e gjyqit dhe jashtë sallës së
11 gjyqit për organizimin e këtij gjykimi.

12 Do të nxjerrim kalendarin në kohë të mjaftueshme
13 paraprakisht lidhur me shqiptimin e aktgjykimit dhe me kaq e
14 deklaroj këtë seancë të mbyllur.

15 --- Seanca mbyllet në orën 15.06

16

17

18

19

20

21

22

23

24